

## **STATUT**

### **I SHOQERISE "CITY CENTER HOTEL SARANDA " SHPK**

Me cilesine e "ortakut themelues " :

**Adela Bytyci**, e datelindjes 30 Prill 1984, i lindur ne Lushnje dhe banues ne Sarande, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar,identifikuar sipas ligjit nepermjet ID I45430128P, leshuar nga MB Tirane me date 07 Mars 2019 dhe **Ana Alushai**, e datelindjes 10 Janar 1964, i lindur ne Mursi-Sarande dhe banues ne Sarande, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar,identifikuar sipas ligjit nepermjet ID G40110153N, leshuar nga MB Tirane me date 15 Nentor 2021 ,te cilet me cilesine e " Ortakut Themelues ", me kerkoi redaktimin e ketij statuti, nepemjet te cilit ai deklarojne se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqerine tregtare, me pernjegjesi të kufizuar, me emertimin **"City Center Hotel Saranda " shpk.**

#### **KREU I**

**Krijimi,Personaliteti juridik,Selia**

#### **Neni 1**

##### **Krijimi**

Shoqeria **"CITY CENTER HOTEL SARANDA " shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pernjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

#### **Neni 2**

##### **Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **"CITY CENTER HOTEL SARANDA " shpk**, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

#### **Neni 3**

##### **Shoqeria e ka seline ne adresen:** Bashkia Sarande- Rruga Telat Noga,

Godina Nr.9 , Hyrja Nr.3.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 4  
Objekti i veprimtarise

- Hoteleri.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar , duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqipetar.

KREU II  
KAPITALI  
Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Ky kapital perbehet nga kontributet:

Znj.Adela Bytyci kontribon me shumen 50.000 leke.

Znj.Ana Alushaj kontribon me shumen 50.000 leke.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare në 2 pjesë.

Ne baze te kontributeve te mesiperme:

**Znj.Adela Bytyci** merr 1 pjesë te kapitalit themeltar me vlerë 50.000(njeqindmije)leke.

**Znj.Ana Alushaj** merr 1 pjesë te kapitalit themeltar me vlerë 50.000(njeqindmije)leke.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar,shlyer plotesisht dhe jane shperndare ndermjet ortakeve si me lart.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakeve. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator i vetem. Administrator i pare i shoqerise eshte emeruar **Znj. Melina Stefani**, me një afat pese vjeçar me te drejtë riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e ortakeve te shoqerise.

Neni 12

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asambleja e ortakeve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët. Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

### Neni 13

#### Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket kane të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortaket kane të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk eshte administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

### Neni 14

#### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

### Neni 15

#### Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### Neni 16

#### Eksperet

Eksperi ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperi kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Asamblese se ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

### Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asambleja e ortakeve, e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibiliteten e fonave ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të

vecante etj.

#### Neni 18

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te të shoqerise.

#### Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar siç mund të jene :

- a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c. Kur ploteshet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoperi ne likuidim e siper ".

#### Neni 20

##### Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaket e shoqërise, në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfitojne pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilis nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

#### Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

#### Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe të jetë i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cilive shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debitore qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

### Neni 23

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plotë me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil,Ligjin per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 24

#### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 25

#### Dispozita perfundimtare

Ky statut hartohet dhe nenshkruhet sot me dt.22 Maj 2023 ne kater kopje me permbytje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe dhe, pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "**CITY CENTER HOTEL SARANDA**" shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet.

Ky statut hyn ne fuqi menjehere pas regjistrimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

### **ORTAKET E SHOQERISE**

**Adela Bytyci**



**Ana Alushaj**

